



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCL-11-0045

Ankuesi

H A Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 12 maj 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Ankuesi i bartë shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 01 dhjetor 2011, ankuesi parashtri ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) MIT018-009, të datës 22 mars 2011, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për paga të pa paguara, në shumë prej 9,466.39 Euro, nga NSH “Përparimi”, (në likuidim).

Me 02 mars 2023, gjykata lëshoi për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 02 mars 2023, Gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim të paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte tentuar të dorëzohet ankuesit me 02 mars 2023 dhe 17 mars 2023, por nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se adresa është e panjohur.

Sipas nenit 116.1 të LPK-së, pala ose përfaqësuesi i saj, në qoftë se gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën, në rastin konkret gjykata ka tentuar ta dorëzojë vërejtjen tek përfaqësuesit e ankuesit në adresën e dhënë nga vet ai, por nga konstatimi i zyrtarit të postës del se pala është shpërngulur.

Gjykata konform dispozitave ligjore, vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore e ka vendosur në tabelën e shpalljeve, nga data 25 prill 2023 deri me 03 maj 2023, komunikimi i gjykatës me ankuesin, i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i ligjshëm.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare